



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 22 Shkurt 2023

Nr: 64

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV NDAJ PERSONIT PËRGJEGJËS TË AUTORITETIT PORTUAL  
DURRËS, PËR RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E  
QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 22 Shkurt 2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim çështjen administrative me:

**SUBJEKT:** Z. Pirro Vengu, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Autoritetin Portual Durrës

**OBJEKT:** Shqyrtim administrativ ndaj personit përgjegjës të Autoritetit Portual Durrës, për raportimin e veprimtarive publike

**BAZA LIGJORE:** Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

**K O N S T A T O J :**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 11.2.2023, në adresën e postës elektronike, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, ka marrë indicie për organizimin e 1 (një) veprimtarie publike nga ana e Autoritetit Portual Durrës.

Indicia është marrë nëpërmjet provave ku pretendohet si në vijim:

Data: 22 Shkurt 2023

Nr: 64  
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të Autoritetit Portual Durrës, për raportimin e veprimtarive publike”

“Në vijim të takimit informues me përfaqësuesit e kompanive ndërkombëtare të interesuara për ndërtimin e portit tregtar në Porto Romano, zhvilluam sot një vizitë në terren. Pjesëmarrësit konfirmuan interesin e tyre për çka do të jetë një nga veprat më strategjike jo vetëm për Shqipërinë, por për të gjithë rajonin”.

Link:<https://www.facebook.com/photo/?fbid=641464477985925&set=pcb.641466807985692>

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi paraprakisht çështjen, vlerësoi se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Më datë 13.2.2023, Autoritetit Portual Durrës i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e marrë, nëpërmjet adresës elektronike

Më datë 15.2.2023, ora 1:53 PM, Autoriteti Portual Durrës bën me dije se: *“Link i mësipërm mban datën 2.2.2023, dhe i përket një postimi në faqen e “Facebook” të “Autoriteti Portual Durrës” me tekst “Në vijim të takimit informues me përfaqësuesit e kompanive ndërkombëtare të interesuara për ndërtimin e portit tregëtar në Porto Romano, zhvilluam sot një vizitë në terren. Pjesëmarrësit konfirmuan interesin e tyre për çka do të jetë një nga veprat më strategjike jo vetëm për Shqipërinë, por për të gjithë rajonin.”*

*Kjo vizitë në terren është pjesë e axhendës së takimit të mbajtur me datë 1.2.2022, me objekt: “Takim paraprak (pre-tender meeting), mbi Ndërtimin dhe Financimin e Projektit të Porto Romano, Durrës”, një aktivitet i raportuar më datë 25.1.2023, nga Autoriteti Portual Durrës në seksionin përkatës të KQZ.*

*Referuar nenit 92, të Kodit Zgjedhor, ju bëjmë me dije se vizita në terren ishte një vizitë krejtësisht teknike pune, në kuadër të takimit të një nate më parë, në të cilën ishin pjesëmarrës vetëm përfaqësuesit e kompanive ndërkombëtare të interesuara për ndërtimin e portit tregëtar në Porto Romano, të cilët ishin të regjistruar dhe pjesëmarrës në takimin e datës 1.2.2023, dhe jo një takim me karakter publik. Në të nuk ishte i ftuar dhe as i pranishëm asnjë media, asnjë i ftuar, asnjë përfaqësues tjetër institucionesh në vend.”*

Nga verifikimi i të dhënave në ndërfaqen e raportimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, rezultoi se Autoriteti Portual Durrës, ka raportuar kryerjen e aktivitetit objekt denoncimi më datë 25.1.2023.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj Autoritetit Portual Durrës, nuk përbën në shkelje të nenit 92, Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

#### **V E N D O S:**

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj z. Pirro Vengu, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në Autoritetin Portual Durrës.
2. Moskonstatimin e shkeljes administrative.
3. Tërheqje vëmendje ndaj Autoritetit Portual Durrës, për marrjen e masave të menjëhershme, për raportimin e veprimtarive publike.
4. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palës nëpërmjet postës elektronike.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**